



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-  
KOMISIONI I KONKURENCËS**

**VENDIM**

**Nr.180 , Datë 29.03.2011**

**“Për**

**një ndryshim në Vendimin Nr. 155, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të Orizit” (i ndryshuar)**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Rezana KONOMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.03.2011, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Zgjatja e periudhës së hetimit paraprak në tregun e importit, dhe tregtimit me shumicë të orizit dhe afatit për përfundimin e hetimit.

**Baza ligjore:** - Neni 24, shkronja d); neni 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar);  
- Ligji Nr. 8485, datë 11. 11. 1999 “Kodi i Procedurave Administrative”;

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Raportit “Mbi Hetimin Paraprak në Tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të orizit” të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, dhe Relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

**VËREN SE:**

1. Me anë të Vendimit Nr. 155, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të orizit”, ndryshuar me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 172, datë 17.01.2011 “Për një ndryshim në Vendimin Nr. 155, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të orizit”, Komisioni i Konkurrencës, si dhe në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar), ka miratuar hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e

importit dhe tregtimit me shumicë të orizit, për të parë nëse kushtet e tregut sigurojnë konkurrencë të lirë dhe efektive.

2. Në zbatim të vendimit të mësipërm, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, ka ndjekur procedurat hetimore të parashikuara në Ligjin 9121 dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe ka përgatitur raportin e hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të orizit brenda afatit kohor të percaktuar në vendimin e Komisionit të Konkurrencës.
3. Gjatë shqyrtimit të Raportit të hetimit paraprak u vu re se që nga muaji Shtator 2010 e në vazhdim tendenca e çmimit të orizit ka qenë në rritje, periudhë kjo e cila nuk është e përfshirë plotësisht në hetim. Komisioni e sheh të nevojshme vazhdimin e hetimit, duke marrë në shqyrtim edhe këtë periudhë. Kjo do të çonte në një vlerësim më të plotë të konkurrencës në tregun nën hetim.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d), nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe Ligjit Nr. 8485, datë 11. 11. 1999 “Kodi i Procedurave Administrative”,

### **VENDOSI:**

1. Në Vendimin Nr. 155, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të orizit”, pika 2 dhe 3, ndryshohen si vijon:  
*“2. Periudha e hetimit do të jetë nga janari 2008 deri më 31 dhjetor 2010.”*  
*“3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak, jo më vonë se data 30 majt 2011”*
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURENCËS**

**Servete Gruda**

**Koço Broka**

**Rezana Konomi**

(\_\_\_\_\_)

(\_\_\_\_\_)

(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

**Anëtar**

**Anëtar**

**Lindita Milo (Lati)**

**K R Y E T A R**